



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH. nr.1037/22**

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Isa Hasani-Anëtar dhe Vedat Poterqoi, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), (Nr.Protokolli 1037/22), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "KONTI" SH.P.K. Prizren me Nr.Unik -(810029753), lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore" me numër identifikues 632-21-8240-1-2-4 dhe numër të brendshëm 632-21-055-121, Loti 1-rë: Blerja e aparaturave mjekësore, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me 18.12.2023, mori:

**V E N D I M**

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e Autoritetit Kontraktues–Komuna e Gjakovës, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "KONTI" SH.P.K. Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender Blerja e aparaturave mjekësore KPSH, stomatologji dhe laborator dhe jo mjekësore" me numër identifikues 632-21-8240-1-2-4 dhe numër të brendshëm 632-21-055-121.

**A r s y e t i m**

Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar me 01.11.2022 nga Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues kërkesën për diskualifikim të OE "KONTI" SH.P.K.-Prizren, me numër identifikues 632-21-8240-1-2-4 dhe numër të brendshëm 632-21-055-121, Loti 1-rë: Blerja e aparaturave mjekësore dhe i njëjti të përfshihet në listën diskualifikuese. Si arsye për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP -së, për OE "KONTI" SH.P.K. me nr. Unik 810029753, me seli ne Prizren AK ka kërkuar që OE-në ne fjalë ta diskualifikojë sipas Nenit 99.2 i LPP-se i cili përcakton: *"Në të. një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSIIP është e obliguar dhe. ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurimi publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare"*. Kurse neni 26.8 i RUOPP përcakton: *"Vërtetim në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën*

*Betim) do të kërkohej të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qellim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të tenderuar është jo më pak se (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë ndie tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se “. KK Gjakovë, me datë 30.09.2022, në përputhje me nenin 26.8 të RRUOPP ka kërkuar nga OE “KONTI” SH.P.K., vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, për aktivitetin e prokurimit 'Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore, i njëjti brenda afatit të kërkuar ligjor kishte ngarkuar në platformën e e-prokurimit vërtetimin nga ATK se nuk ka obligime borxhe të tatimeve në ATK dhe vërtetimin e lëshuar nga një Gjykatë kompetente se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë.*

Me 02.10.2022, menjëherë pasi AK publikon Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit ku OE “KONTI” SH.P.K., shpërblehet me kontratë për Loti I, OE i ka tërhequr nga platformë e e-prokurimit Vërtetimin e ATK-së dhe Vërtetimin e Gjykatës dhe po të njëjtën ditë me 12.10.2022, përmes e-mailit ka njoftuar Autoritetin kontraktues se tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës ku ka cekur disa arsye përfshirë se tani nga prodhuesi nuk mund të siguroj paisjet sepse të njëjtat më nuk prodhohen nga prodhuesi për shkak të ndryshimeve të mëdha në treg.

Në përgjigjen e dhënë nga OE për OSHP, i njëjti sqaron se AK me datën 21.12.2021 kishte anuluar aktivitetin e prokurimit për LOT 1 LOT 2 LOT 3 dhe LOT 4. Kundër vendimit të cituar OE ankues edhe pse kishte pasur të drejtë ta atakoj vendimin fillimisht tek AK pastaj tek Organi shqyrtues i prokurimit nuk e ka bërë se është pajtuar me anulimin e publikuar, Megjithatë për këtë aktivitet kundër vendimit për anulim vetëm një OE kishte parashtruar ankesë në OSHP dhe atë vetëm për LOT 3, kurse AK në kundërshtim me LPP e ka pezulluar aktivitetin e-prokurimit në tërësi, OE sqaron se përderisa ishim pajtuar me vendimin e AK për anulim, AK është dashur të vazhdojë me anulimin e llojeve përkatëse LOT 1,2 dhe 4 dhe jo të vijoj me shkelje të tilla procedurale, dhe po ashtu duhet të potencohet se AK ka bërë edhe shkelje tjera në këtë procedurë sepse e njëjta nuk kishte kërkuar vazhdimin e validitetit të tenderit, pavarësisht që kishte skaduar afati por e njëjta kishte kërkuar një gjë të tillë pas 25 ditëve pas skadimit të vlefshmërisë së ofertave tona. Megjithatë pas vendimit të OSHP 16/22 të datës 05.08.2022 i cili vendim nuk e kishte shqyrtuar fare ankesën për LOT 3 por e kishte hedhur jashtë afatit për shqyrtim.

Me 07.10.2022, AK na njofton në OE pjesëmarrës në këtë aktivitet se ne kemi fituar një tender për të cilin ne menjëherë ne i ngarkojmë në e-prokurim vërtetimin nga Gjykata dhe vërtetimin nga ATK dhe po ashtu menjëherë pas kësaj komunikojmë me prodhuesin, i cili me datën 01.11.2022 na njofton se disa produkte nuk prodhohen më nga prodhuesi, andaj përderisa me vet fajin e AK është pezulluar LOT 1 ku ne kemi qenë ofertues dhe përderisa ka kaluar rreth një vit nga hapja e tenderit është e kuptueshme që edhe prodhuesit të cilën ai kanë dhënë autorizimet të kenë

ndryshime në prodhimet e tyre. Sepse edhe prodhuesit i ka prekur kriza globale ndërsa dihet se ne jemi vetëm distributor dhe jo prodhues, andaj kërkojmë nga paneli që kërkesa e till të refuzohet si e pabazuar sepse pikërisht AK ka vepruar në kundërshtim me LPP në këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues në shkresat e saj ka pohuar mes tjerash se këto arsye nuk qëndrojnë dhe nuk kanë bazë ligjore kurse OE është dashur të kërkoj sqarime shtesë menjëherë pas hapjes së tenderit nga prodhuesi.

#### -Konstatimi i panelit shqyrtues-

Pas administrimit të provave në shkresat e lëndës Paneli vëren se AK me datën 21.12.2021 kishte anuluar aktivitetin e prokurimit për LOT 1 LOT 2 LOT 3 dhe LOT 4. Kundër vendimit të cituar OE ankues edhe kishte pasur të drejtë ta atakoj fillimisht tek Autoriteti Kontraktues pastaj tek Organi shqyrtues i prokurimit, këtë të drejtë nuk e kishte shfrytëzuar dhe rrjedhimisht në kuptim të LPP i njëjti kishte humbur statusin e palës me interes juridiko-material për këtë aktivitet të prokurimit në kuptim të nenit 4 paragraf 1.26 të LPP.

OSHP lidhur me këtë aktivitet kishte pranuar vetën një ankesë dhe atë vetëm për LOT 3, e cila si e till ishte hedhur jashtë afatit për shqyrtim nga OSHP. Megjithatë AK sipas disrektionit të saj kishte vendosur ta kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim për ti gjitha llotet, kurse pas procedurës së rivlerësimit kishte rekomanduar OE-subjekt tani për diskualifikim për kontratë, i cili sipas vlerësimit të pavarur të këtij paneli e kishte humbur statusin e palës së interesuar, si i till nuk mund të konsiderohet si palë me interes juridiko-material. Nga ana tjetër ankuesi ka pohuar po ashtu në shkresat e tij/saj se nuk qëndrojnë arsyet e kërkesës së AK për diskualifikim në asnjë rrethanë sepse nuk kanë asnjë mbështetje ligjore ngase sipas tij/saj meqenëse kishe kaluar kohe relativisht e gjatë nga iniciimi i këtij aktiviteti 30.11.2021 deri me datën 11.10.2022, i njëjti pa fajin e tij ishte informuar nga prodhuesi se pajisjet për të cilat e kishte mbështetur dhe njëherësh kishe ofertuar ankuesi, për shkak të ndryshimeve të mëdha të çmimeve në treg, nuk do të mund ta pajisjet me çmimet e dakorduara, kurse si provë për panelin kishte bashkangjitur dëshmitë /komunikimet relevante me prodhuesin, po ashtu vlen të cekët se ankuesi brenda afatit kishte deklaruar/ngarkuar ne e-prokurim vërtetimin nga Gjykata dhe vërtetimin nga ATK.

Paneli Shqyrtues mori në shikim të gjitha shkresat e kësaj lënde të cilat i analizoi në kontekstin e veprimeve të ndërmarra nga të dyja palët, nga kuadri aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër dhe konstatoi se, kërkesa e AK në rastin konkret, në kuptim të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, është e pabazuar. Paneli shqyrtues i vlerëson si të qëndrueshme pohimet e operatorit ekonomik dhe konsideron se kërkesa për diskualifikim nuk përfshihet në kualifikimet e parashikuara me dispozitën e nenin 99 të LPP. Paneli vëren nga shkresat e kësaj lënde se AK nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE përkundrazi mund të vërehet se gjatë kësaj procedure prokurimi ka pasur lëshime procedurale nga AK, andaj Paneli shqyrtues i tërheq vërejtjen zyrtarit përgjegjës të prokurimit

duke e njoftuar se ka të drejtë në kuptim të nenin 25 të LPP të kërkoj ndërmarrjen e masave eventuale nëse edhe një herë vëren të tilla lëshime/veprime nga AK.

Kryetare e Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj Mexhuan



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK –Komuna e Gjakovës;
- 1x1 OE –“Konti” Sh.p.k. Prizren;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.